



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria -Vlada-Government*  
Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit  
Ministarstvo Infrastruktura i Transporta  
Ministry of Infrastructure and Transport

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit , në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) , të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe nenin 38 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Rregulloren Nr.26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarëve me autobus, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2016 dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë:

## VENDIM

**I. Aprovohet** kërkesa nr.2142 e operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus "Albani Tours"SHPK me seli në Ferizaj për marrjen e nisjes në relacionin Ferizaj-Gjilan dhe anasjelltas me nisje (08:20 - 10:00).

### *Arsyetim.*

Pas shqyrtimit të aplikacioneve dhe verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht Ligjin nr.04/L-179 për Transportin Rrugor në mbështetje të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarëve me autobus i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.06/2016, është konstatuar që operatori transportues rrugor të udhëtarëve me autobus "Albani Tours"SHPK me seli në Ferizaj , **ka plotësuar** kushtet ligjore për ndarjen e nisjeve të lira në relacionin e lartëcekur të përcaktuara sipas nenit 8 të U.A

nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin nderurban të udhëtarëve me autobus si dhe kushtet e shpalljes publike për marrjen e nisjes nerelacionin Ferizaj-Gjilan dhe anasjelltas me nisje (08:20 - 10:00).

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë, është vendosur si në dispozitiv.

### Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrojë ankesë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e publikimit të vendimit.



I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Operatorit Transportues;
- Arhivit.